



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE**

### **EKSTRAKT**

**nga procesverbali i mbajtur më 5 tetor 2016, në mbledhjen e XXVIII (njëzetetë) të Komitetit për Komunitete.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.00'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Bahri Selimi, Shaban Osmani, Mefail Rama, Radisav Perović dhe Xhafer Ademi, ndërsa mungoi Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Halit Vërshefci, shef i Sektorit të Shëndetësisë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Fadil Babatinca, Policia e Kosovës, Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, Skënder Shatri dhe Bekim Karaxhija, OSBE, dhe Daniel Dlan, KFOR - LMT.

Në cilësinë e mysafirit i pranishëm ishte edhe Kenan Ademi.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, propozoi që në rend dite të përfshihet edhe:

**- Informata për pjesëmarrjen e pjesëtarëve të komuniteteve RAE në trajnimin profesional për mënyrën e aplikimit në Policinë e Kosovës.**

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri së bashku me propozimin e kryesuesit.

### **2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Komunitete më 15 shtator 2016**

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

### **3. Shqyrtimi i mundësive për gjetjen e donatorëve eventual për sigurimin e lëndës djegëse për ngrohje gjatë dimrit për familje me nevojë të komuniteteve pakicë**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, kjo çështje është shqyrtuar edhe vitin e kaluar mirëpo përkundër përpjekjeve nuk kemi arritur që të sigurojmë lëndë djegëse për ngrohje për asnjë familje.

**z. Shaban Osmani**, theksoi, për sigurimin e lëndës djegëse për ngrohje për pjesëtarët e komuniteteve pakicë në gjendje të rëndë sociale, ne në emër të Komitetit për Komunitete së pari duhet t'i drejtohem me kërkesë Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale por që paraprakisht të identifikohet numri i familjeve konkrete të cilat janë në gjendje sociale më të rëndë.

Drejtorja e cekur do ta shqyrtoj atë kërkesë dhe nëse ka mundësi do ofroj ndihmën përkatëse.

Sa i përket donatorëve konsideroj se do të ishte mirë që njoftimi për këtë të bëhet edhe në mjetet e informimit.

**z. Halit Vërshefci**, shef i Sektorit të Shëndetësisë në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, sa i përket ofrimit të ndihmës të lëndës djegëse për ngrohje, kjo çështje është shqyrtuar edhe vitin e kaluar, mirëpo për shkak të mungesës të programit të këtyre paraqiten vështirësi për ofrimin e ndihmës përkatëse.

U përmend që të shtrohet kërkesa, ne në kuadër të Drejtorisë do t'i shqyrtojmë të gjitha mundësitë se çka mund të bëjmë në këtë drejtim.

**z. Liman Zeqiri**, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, theksoi, çështja për të cilën po debatohet e ka një rëndësi të veçantë, këtë e them duke e ditur situatën e rëndë sociale, ekonomike dhe rrethanat e papunësisë nga kjo kuptohet se nevojat janë të shumta. Konsideroj se është mirë me pasë një pasqyrë të saktë se sa familje janë në gjendje më të rëndë ekonomike.

Në rrethanat aktuale është shumë vështirë të gjenden donatorë, mirëpo duhet shikuar mundësitë që kjo çështje të realizohet përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Institucioneve tjera përkatëse.

Në cilësinë e shefit të ZKKK – së e mbështes propozimin që të bëhet lista e familjeve më në nevojë dhe premtoj se do të angazhohem për ofrimin e ndihmës përkatëse.

**z. Xhafer Ademi**, theksoi, duke u bazuar se nuk e kemi ndonjë OJQ e cila merret me donacione por edhe në atë se me buxhetin e Komunës nuk është paraparë ndonjë ndihmë e kësaj natyre, është mjaftë vështirë që për familjet të cilat kanë nevojë shumë të madhe të sigurohen drutë për ngrohje. Këtë e them duke u bazuar se edhe vitin e kaluar nuk kemi mundur të realizojmë këtë çështje.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, ne duhet t'i shqyrtojmë të gjitha mundësitë dhe nëse nuk kemi sukses të mos mbetet faji në mos angazhimin tonë dhe shtoi, jam i mendimit se për identifikimin e familjeve të cilat kanë më së shumti nevojë për dru për ngrohje të ngritët një komision e cili do ta bëjë listën përkatëse.

**z. Bahri Selimi**, theksoi, jam i mendimit se mënyra më e mirë do të ishte që kjo çështje të procedohet në Kuvend në mënyrë që Drejtorisë kompetente t'i lehtësohet mundësia e ofrimit të kësaj ndihme ngase edhe përfaqësuesi i Drejtorisë përkatëse tha se kjo çështje është shqyrtuar edhe më herët dhe nuk

kanë mundur të gjejnë zgjidhje. Përndryshe ndihmë në aspektin e druve për ngrohje ka edhe një pjesë e qytetarëve të komunitetit shumicë, mirëpo pajtohem që komuniteteve RAE t'ju jepet kjo ndihmë por që paraprakisht të përpilohet lista e familjeve të cilat janë në gjendje më të rëndë sociale.

**z. Mefail Rama**, theksoi, pajtohem me parafolësit se për ofrimin e ndihmës për dru për ngrohje kanë edhe qytetarët e komunitetit shumicë dhe komuniteteve pakicë. Në një prej mbledhjeve të kaluara të këtij Komiteti e kemi shqyrtuar buxhetin e Komunës për vitin 2017 dhe atëherë kemi shtruar nevojën që në buxhet të parashihen edhe ndihmat e nevojshme, por kjo nuk është përfshirë në buxhet.

**z. Shaban Osmani**, theksoi, jam i mendimit se për ofrimin e ndihmës për dru të ngrohjes, përveç Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me kërkesë do duhej t'i drejtohem edhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Ministri e cila Komunës së Podujevës i ka ndihmuar shumë pak për të mos thënë fare.

Në vazhdim, pas votimit, njëzëri u konstatua që pjesëtarët e komuniteteve RAE, përkatësisht Shaban Ahmeti, Xhafer Ademi dhe Mefail Rama të përgatitin listën e familjeve të komuniteteve RAE të cilat janë në gjendje më të rëndë sociale dhe kanë nevojë më të madhe për ofrimin e ndihmës të druve për ngrohje, e pastaj në emër të këtij Komiteti t'i bëhet kërkesë Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim që të shqyrtojnë mundësitë për ofrimin e ndihmës për të cilën po debatohet.

#### **4. Informata për pjesëmarrjen e pjesëtarëve të komuniteteve RAE në trajnimin profesional për mënyrën e aplikimit në Policinë e Kosovës.**

**z. Bekim Karaxhija**, përfaqësues i OSBE – së, theksoi, në mes datave 28 dhe 30 shtator 2016 është mbajtur një trajnim i organizuar nga OSBE – Departamenti për Siguri Publike, në këtë trajnim pjesëmarrës kanë qenë pjesëtarët e komuniteteve RAE me qëllim që të informohen lidhur me konkurset, procedurat dhe informacionet e nevojshme për konkurrim në Policinë e Kosovës. Në trajnim ligjëratat janë mbajtur nga zyrtarë me përvojë mjaftë të madhe dhe pjesëmarrësit janë informuar për të gjitha çështjet e rëndësishme në këtë lëmi.

Po ju rikujtoj se ky aktivitet është bërë në bashkëpunim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe Komitetin për Komunitete.

Në këtë trajnim, në propozim të Komunës së Podujevës, kanë marrë pjesë 4 pjesëtarë të komuniteteve RAE.

**z. Kenan Ademi**, pjesëmarrës në trajnimin e organizuar nga OSBE, theksoi, në trajnim jemi informuar për rregullat e Policisë së Kosovës, për mënyrën e plotësimit të testeve në procedurën e konkurrimit, për nevojën e angazhimit të femrave në Policinë e Kosovës si dhe çështje të tjera me rëndësi.

Përndryshe kemi kaluar shumë mirë dhe kemi qenë shumë të kënaqur me të gjithë ligjëruesit.

**z. Bekim Karaxhija**, përfaqësues i OSBE – së, sipas informacioneve që i kemi, në janar 2017 pritet të hapet një konkurs për plotësimin e vendeve të lira në Policinë e Kosovës dhe se përgjegjësja e trajnimit për të cilin po debatojmë është deklaruar se ka qenë e kënaqur me një numër të madh të pjesëmarrësve në trajnim dhe është zotuar se pjesëtarëve të këtyre komuniteteve do t'ju ndihmoj në kuptimin e trajnimeve shtesë.

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, e falënderoj OSBE – në për bashkëpunimin e ndërsjellë, organizimin e trajnimit për pjesëtarët e komuniteteve RAE dhe informacionet e paraqitura në këtë mbledhje.

**z. Liman Zeqiri**, theksoi, e falënderoj OSBE – në për iniciativën dhe organizimin e trajnimit për pjesëtarët e komuniteteve RAE lidhur me mënyrën e konkurrimit në Policinë e Kosovës dhe shtoi, afati për përpilimin e listës së pjesëmarrësve në këtë trajnim ka qenë mjaftë i shkurtë por fal angazhimit të anëtarëve të këtij Komiteti nga radhët e komuniteteve RAE, përkatësisht Shaban Ahmetit, Xhafer Ademit dhe Mefail Ramës, janë caktuar kandidatët e mundshëm prej gjashtë personave dhe lista më është dorëzuar së bashku me fotokopje të letërnjoftimeve të personave të cilët kanë qenë të interesuar të jenë pjesëmarrës të trajnimit të cekur, listë të cilën OSBE – së ia kam përcjellë në mënyrë elektronike. Përse në trajnim nuk kanë marrë pjesë të gjithë personat sipas listës së dërguar, por vetëm katër prej tyre, unë nuk jam në dijeni.

Përndryshe trajnimet e këtilla janë në interes të qytetarëve e në veçanti qytetarëve nga radhët e komuniteteve pakicë, andaj e shfrytëzoj rastin dhe e falënderoj OSBE – në për organizimin e këtij trajnimi duke përfshirë transportin dhe akomodimin e pjesëmarrësve.

## **5. Të ndryshme**

Nuk pati diskutime.

**Mbledhja përfundoi në orën 11.35'.**

**Procesverbalin e mbajti**

**Faik Gashi**

**Nr. 01-006-79927**

**Podujevë,**

**5 tetor 2016**

**Kryesuesi i Komitetit**

**Shaban Ahmeti**